



Në bazë të nenit 4 paragrafi 1 i Vendimit për Stimuj dhe Investime në Zhvillimin e Bujqësisë të Komunës së Tuzit ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi – Rregulloret Komunale", Nr. 020/23 datë 27.04.2023) si dhe Programit të masave për realizimi i mjeteve për zhvillimin e prodhimitarisë bujqësore në komunën e Tuzit për vitin 2025 - Agrobuxheti ("Gazeta zyrtare e Malit të Zi – rregulloret komunale" Nr. 01-307/25-3175/2 od 25.06.2025) Sekretariati për Bujqësi dhe Zhvillim Rural shpall

THIRRJE PUBLIKE PËR PAGESA DIREKTE PËR KOKË BAGËTIE PËR VITIN 2025

I

Përfitues të mjeteve mbështetëse sipas kësaj Thirrje Publike janë njësitë bujqësore, të regjistruara në momentin e paraqitjes së kërkesës për dhënie të mbështetjes, në regjistrin e ekonomive bujqësore nga lëmia e prodhimitarisë blegtorale që mbahet nga Ministria e Bujqësisë, Administrimit të Ujërave dhe Pyjeve.

II

Mbështetja në këtë Thirrje Publike ka të bëjë me premia për kokë për lopët dhe mëshqerrat, premia për kokë për dhentë dhe dhitë, premiat për rritjen e derrave dhe priemiat për rritjen e pulave vezore si she primet për kokë bagëtie qumështi i të cilave përpunohet në vend dhe nën kontrollin e ministrisë përkatëse..

III

Primiat për lopët dhe mëshqerra - të gjitha fermat që rrisin një ose më shumë nga këto lloje të gjedheve kanë të drejtë për mbështetje, për çdo krerë. Kriteri plotësohet nëse ferma e mban atë numër krerësh për shtatë muaj deri në momentin e dorëzimit të kërkesës dhe pronari i fermës banon në Komunën e Tuzës. Premia bazë për kokë për lopët dhe mëshqerra është deri në 50 € për kokë.

b) Fermat që rritin më shumë se 10 dele dhe/ose më shumë se 10 dhi në një tufë. Mbështetja ka të bëjë për çdo krerë. Kriteri plotësohet nëse ferma e mban atë numër krerësh për shtatë muaj deri në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe pronari i fermës ka vendbanim në Komunën e Tuzës. Premia bazë për kokë për delet dhe dhitë është deri në 6 €.

c) Primi për rritjen e derrave është deri në 20 € për kokë, premia realizohet për fermat që rritin dy ose më shumë krerë, për çdo krerë.

d) Premia për rritjen e pulave vezore, shuma e primave është deri në 0,50€ për pulë, për realizimin e kësaj mbështetje minimum I pulave në tufë është 100 pula për fermë, për çdo copë.

e) Primi shtesë i referohet mbështetjes për kokë bagëtie, qumështi i të cilave përpunohet në fermë dhe do të arrijë deri në 75 euro për lopët, ndërsa për delet dhe dhitë do të arrijë deri në 10 euro për kokë.

Nëse shuma totale e kërkesave për pagesa mbështetëse tejkalon shumën e planifikuar me buxhet, pagesat zvogëlohen proporcionalisht. Për zbatimin e kësaj mase të paraparë në komponentin buxhetor të subvencionit për mbështetjen e prodhuesve bujqësorë, që i referohet pagesave direkte për krerë bagëtie, është caktuar shuma prej 80.000,00€.

IV

Dokumentacioni i nevojshëm për realizimin e kësaj mbështetje:

- Kërkesa e plotësuar për dhënien e mbështetjes për pagesa direkte për kokë bagëtie për vitin 2025 (e cila është pjesë përbërëse e kësaj Thirrjeje Publike);
- Vendimi për regjistrimin në Regjistrin e Ekonomive Bujqësore të nxjerrë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujërave;
- Vërtetim për statusin e numrit nga ambulance veterinare kompetente për gjedhë (lopë dhe mëshqerra), dhe për bagëtitë tjera regjistrim vjetor i statusit të numrit nga ambulanca veterinare kompetente;
- Vërtetimi për bagëtitë që përdoren për perpunim të qumshutit
- Fotokopje e kartës së identitetit dhe
- Fotokopje e llogarisë rrjedhëse.

V

Formulari i kërkesës për ndarjen e mbështetjes për pagesa direkte për krerë bagëtie për vitin 2025 (SHTOJCA I) mund të shkarkohet nga faqja e Komunës së Tuzit (www.tuzi.org.me) dhe në zyrën e Sekretariatit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Formulari i kërkesës i plotësuar për ndarjen e mbështetjes për pagesa direkte për krerë bagëtie për vitin 2025 me dokumentacion përkatës dorëzohet në arkivin e Komunës së Tuzit.

Informacionet lidhur me këtë thirrje publike mund të merren në numrat e telefonit: 020/ 875 167; 067/ 179 - 284 dhe 067/ 083 - 369.

Përpunimi i kërkesave të pranuar do të bëhet gjatë kohëzgjatjes së thirrjes publike, ndërsa pagesa do të bëhet pas përfundimit të thirrjes publike dhe jo më vonë se fundi i vitit kalendarik.

Kërkesat për mbështetje dorëzohen nga data 03 Korrik deri më 15 Gusht 2025.

VI

Aplikanti është përgjegjës për saktësinë e të dhënave dhe dokumentacionit për realizimin e të drejtës për mbështetje. Nëse në procedurën e kontrollit në terren konstatohet se aplikanti në ndonjë mënyrë ka mashtruar ose ka çuar në përfundim të gabuar personin përgjegjës për dhënien e mbështetjes, ai do të përjashtohet nga programi i mbështetjes për vitin aktual.

Dokumentacioni i plotë duhet të dorëzohet nga aplikanti ose një person i autorizuar nga aplikanti.

Komuna e Tuzit, Sekretariati për Bujqësi dhe Zhvillim Rural ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë nëse është e nevojshme.

Pas dorëzimit të dokumentacionit të plotë, Komuna e Tuzit, Sekretariati për Bujqësi dhe Zhvillim Rural kryen kontrollin administrativ dhe në terren, përgatit procesverbalin e kontrollit në terren që bëhet pjesë përbërëse e dokumentacionit dhe merr vendim për pranim/refuzim të kërkesës.

Kontrollet e kërkesave do të kryhen në vazhdimësi, sipas dinamikës së paraqitjes së kërkesave.

Shuma e miratuar e mbështetjes do të paguhet në llogarinë xhiro të aplikantit, pas përpunimit të kërkesës dhe miratimit të Vendimit për mbështetje.

Dokumentacioni i dorëzuar jo i plotë dhe pas afatit të definuar nuk do të merret parasysh.

